



# NJOFTIM PËR KONTRATË

## Kontratë Furnizimi Procedurë e hapur

Në përputhje me Nenin 10 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)

Data: 18.02.2026

Nr. i Prokurimit: “BQK 26 008 121”

### I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

### II LËNDA E KONTRATËS

#### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: “Furnizim me pjesë për makinën për procesim të keshit”
Lloji i prokurimit: Furnizim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): N/a
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës: 46,935.00 euro
Ndarja në Pjesë: JO

### III INFORMACIONE PËR LLOJIN E FURNIZIMIT

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale furnizimin me module të lidhjes të makinave BPM, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t’u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

#### IV KRITERET E PËRZGJEDHJES<sup>1</sup>/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t’i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<p>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 në rast se aplikohet)) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 1:</u></b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p><b><u>Evidenca 1:</u></b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.</p> <p><b><u>Kërkesa 2:</u></b> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”</p> <p><b><u>Evidenca 2:</u></b> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.</p> <p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.</p> <p><b><u>Kërkesa 3:</u></b> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p> <p><b><u>Evidenca 3:</u></b> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohet si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë,</p>
--	---

<sup>1</sup> Sipas nenit 32 të Rregullës për prokurimin në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.</p> <p>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të kësaj Rregulle. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 4:</u></b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 4:</u></b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Kërkesa 5:</u></b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b><u>Evidenca 5:</u></b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><b><u>Kërkesa 6:</u></b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><b><u>Evidenca 6:</u></b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>N/a</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë</p>	<p><b><u>Kërkesa7:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të natyrës së ngjashme të furnizimeve, gjatë 3 (tri) viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025, përfshirë edhe 2026 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate) .</p> <p><b><u>Evidenca 7:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat përkatëse ose referencat që evidencojnë realizimin e</p>

<p><i>kategori të dokumenteve mund të kërkojen dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p>furnizimeve dhe</p> <p>b) kopjet e kontratave përkatëse.</p> <p><b><u>Kërkesa 8:</u></b> Ofertuesi duhet ta plotësoj formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 8:</u></b> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me furnizimet e ngjashme të realizuara ne tri vitet e fundit duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumen e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej furnizimeve;</p> <p><b><u>Kërkesa 9:</u></b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Katalogun- me specifika teknike, detaje te artikujve të ofruar (sipas kërkesës në tabelën e specifikave teknike).</p> <p><b><u>Evidenca 9:</u></b>Katalogu me specifika teknike të produktit të ofruar të ketë të shënuar qartë produktin e ofruar , ashtu sic është kërkuar në specifikat teknike.</p> <p><b><u>Kërkesa 10:</u></b> Dëshmi e autorizimit ose partneritetit nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i tij i autorizuar që vërteton te drejtën e tenderuesit për ofertim, furnizim dhe realizim të kontratës.</p> <p><b><u>Evidenca 10:</u></b> Autorizimi ose marrëveshje partneriteti, e lëshuar nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i tij i autorizuar</p>
--	--

## V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: “Procedure e hapur” (*Neni 10 i Rregullës për Prokurimin në BQK*)

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “*Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët*” (në përputhje me nenin 34 të Rregullës për prokurimit në BQK)

## VII. INFORMATA ADMINISTRATIVE

<p>Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit:</p> <p>Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 27.02.2026, ora 12:00, në e-mail adresën zyrtare: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>.</p>
<p>Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 27.02.2026, ora 14:00, në e-mail adresën zyrtare: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>.</p>
<p>Dokumentet me pagesë: Jo</p>
<p>Afati i fundit i dorëzimit të ofertave, data: 02.03.2026, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, Rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.</p>
<p>Takimi për hapjen e ofertave, data: 02.03.2026, ora 14:30, Objekti i BQK-së, Rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.</p>

Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 2,000.00 € (dy/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite nga data e hapjes së ofertave. (dorëzohet me ofertë).

Kushti i sigurimi të kontratës: Kushti i sigurimi të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.

Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertave

### VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar<sup>2</sup> lidhur me këtë procedurë duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

### IX. ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/451	Fax: 038 243 763

<sup>2</sup> Sipas pikës 1.26 të Nenit 2 të “Rregullës për Prokurimin në BQK”, “palë e interesuar” është operatori ekonomik i cili mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.